




INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË  
PUBLIKE TË KOSOVËS



**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCË, COVID-19 DHE  
PATOGENËT TJERË RESPIRATORË NË KOSOVË,  
SEZONA 2025/2026 (JAVA 52-TË)**

**Simptomet e Gripit përfshijnë:**

- Temperaturë/ethe
- Kokëdhimbje
- Lodhje
- Kollë e thatë
- Dhimbje fyti
- Rrjedhje hundësh
- Dhimbje muskulare
- Simptome gastrointestinale, si nauze dhe barkqitje




**PËRMBLEDHJE**

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë tërë vitit bën mbikëqyrjen permanente të Influençës sezonale (ILI), ARI dhe SARI me intensifikim të aktiviteteve gjatë sezonës përkatëse. Mbikëqyrja realizohet përmes hulumtimit aktiv dhe pasiv në institucione shëndetësore dhe terren.

**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË,  
2021/2022 - 2025/2026**

Sipas grafikoni 1, ku janë paraqitur rastet e Influencës sezonale (ILI) në 5 sezonat e fundit shohim se sezona 2025/2026 karakterizohet me numër më të lartë të rasteve të raportura, krahasuar me periudhën e njejtë të sezonës 2024/2025 dhe fillim të aktivitetit nga java e 40-të e sezonës 2025/2026.

Grafikoni.1



**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2025/2026  
DHE PRAGU EPIDEMIK**


Nga fillimi i sezonës, 29 shtator 2025 deri më 28 dhjetor 2025 (java e 52-të) në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë raportuar 25,123 raste të Sëmundjes të ngjashme me Grip (ILI), 4,414 raste të Infeksioneve respiratore akute (ARI) dhe 35 raste me Infeksion të rëndë respirator akut (SARI).

Gjatë javës së 52-të (22.12.2025-28.12.2025) janë raportuar 4,031 raste ILI (Sëmundje e Ngjashme me Gripin), 436 raste ARI (Infeksion Respirator Akut) dhe 6 raste SARI (Infeksion i Rëndë Akut Respirator).

Përmes sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe paralajmërimit të hershëm (SMSN) janë raportuar 474 raste ILI, 30 raste ARI dhe 6 SARI.


**Intensiteti i Influencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për javën e 52-të paraqitet në aktivitetin e lartë të qarkullimit dhe krahasuar me javën e kaluar shënon rritje prej 11.9%. (Graf.2)**

Grafikoni.2



Në grafikoni 3 shohim se në të gjitha komunat janë raportuar raste të dyshimta në Influencë dhe sipas numrit të rasteve të raportuara, numër më të lartë kanë komuna e Prishtinës, Mitrovicës, Pejës dhe Prizrenit ndërsa sipas Incidencës numër më të lartë të rasteve kanë komuna e Kamenicës, Shtimes dhe Mitrovicës.

Grafikoni.3






**MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE**

Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influcencës – IKSHPK nga fillimi i sezonës 2025/2026 deri më 31 dhjetor 2025, janë testuar gjithsej 2,473 mostra nga pacientët e qendrave sentinel dhe jo sentinel si raste të dyshimta në ILI, ARI dhe SARI. Nga mostrat e testuara 1,239 (50.1%) prej tyre të dyshimta në SARS-CoV-2 dhe 1,234 (49.9%) të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë. Gjatë kësaj periudhe në SARS-CoV-2 janë konfirmuar 20 raste (1.6%). Nga 1,234 mostrat e testuara në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë janë konfirmuar 246 raste me Influcencë A (pozitiviteti 19.9%). Rastet e konfirmuara me Influcencë A janë nga komuna e Prishtinës (98 raste), Mitrovicë (54 raste), Fushë Kosovë (14 raste), Malishevë (11 raste), Vushtrri (9 raste), Ferizaj (8 raste), Podujevë (8 raste), Lipjan (7 raste), Drenas (5 raste), Skenderaj (5 raste), Gjakovë (4 raste), Gjilan (4 raste), Pejë (3 raste), Suharekë (3 raste), Kaçanik (3 raste), Klinë (2 raste), Viti (2 raste), Rahovec (2 raste) dhe me nga 1 rast komunat : Novobërdë, Graçanicë, Obiliq dhe Prizren, dhe i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (116 raste), 5-14 vjeç (67 raste), 15-34 vjeç (26 raste), 35-50 vjeç (11 raste), 51-64 vjeç (8 raste) dhe 65+ (18 raste). Gjatë javës së pesëdhjetë e dy (22.12.2025-28.12.2025), nga labororet private janë raportuar gjithsej 72 mostra të testuara si të dyshimta në SARS-CoV-2. Nga këto mostra nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv. Nga patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar: 159 mostra me RSV, 224 mostra me Human Rhinovirus, 123 mostra me Human Adenovirus, 27 mostra me Parainfluenza Virus dhe 9 mostra me Metapneumovirus (Graf.5).


Rastet pozitive në RSV (12.9%), janë nga komuna e Prishtinës (72 raste), Fushë Kosovë (24 raste), Ferizaj (11 raste), Podujevë (9 raste), Lipjan (5 raste), Malishevë (4 raste), Obiliq (3 raste), Viti (3 raste), Prizren (3 raste), Gjilan (3 raste), Mitrovicë (3 raste), Rahovec (2 raste), Vushtrri (2 raste), Hani i Elezit (2 raste), Kaçanik (2 raste), Klinë (2 raste), Shtime (2 raste) dhe me nga 1 rast komuna: Deçan, Drenas, Gjakovë, Istog, Suharekë, Novobërdë dhe Pejë. Rastet pozitive me RSV i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (138 raste), 5-14 (11 raste), 15-34 (4 raste), 35-50 (1 rast) dhe 65+ (5 raste) (Graf.5).

Grafikoni.5



Sipas subtipit: me subtipin AH3 janë konfirmuar 32 raste apo 13%, me subtipin AH1N1 janë konfirmuar 12 raste apo 5% dhe me Influencë A të pa subtipizuar janë konfirmuar 202 raste apo 82%. (Graf.6.)

Grafikoni. 6



### AKTIVITETET SEZONALE

IKSHPK/Departamenti i Epidemiologjisë bënë mbikëqyrjen e Influencës gjatë tërë vitit, me intensifikim të saj gjatë sezonës përkatëse (java e 40 deri në javën e 20).

Përcjell situatën epidemiologjike me rastet ILI/ARI (javore) dhe rastet me SARI (në bazë ditore/alerti).

Bënë testimin laboratorik të mostrave në Departamentin e Mikrobiologjisë/Qendrën Kombëtare për Testimin e Influencës.

Ka dhënë këshilla për popullatën për mbrojtjen nga sëmundja dhe njohjen e simptomeve të saj.

### MASAT PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË VIRUSIT TË GRIPIT SEZONAL

Aktiviteti i gripit për sezonën 2025/2026, është në nivel më të lartë krahasuar me sezonën paraprake dhe masat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve respiratore janë:

Mbajtja e maskave.

Distanca fizike.

Higjiena e duarve.

Evitimi i kontakteve të afërta me individë të sëmurë.

Redukimi i vizitave të familjarëve tek personat e hospitalizuar (SHSKUK, Spitalet rajonale).

Evitimi i vendeve të mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.

Ushqimi i shëndetshëm me shumë vitamina.

Aktiviteti fizik dhe gjumë i mjaftueshëm.

Personat e sëmurë të qëndrojnë në shtëpi.

- Pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve ku qëndroni.
- Mbulimi i hundës dhe gojës me një shami gjatë teshtitjes dhe kollitjes si dhe hudhja më pas në vend të sigurt.
- Larja e duarve shpesh me ujë dhe sapun, ose solucione duarsh me alkool.
- Sytë, hunda dhe goja të mos preket me duar të kontaminuar, pasi virusi përhapet në këtë mënyrë.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe objekteve që mund të jenë kontaminuar nga virusi.

### **Konsultimi me mjekun për mjekimin me barna kundër gripit, të cilat duhet të merren vetëm me rekomandimin e mjekut**

Medikamentet kundër gripit duhet të fillohen brenda 48 orëve të para të fillimit të sëmundjes për të pasur efektivitet të lartë.

Ato mund të parandalojnë edhe komplikimet e rënda që mund të vijnë nga gripit.

Mënyra më efikase për parandalimin e virusit të gripit është Vaksinimi me vaksinën kundër gripit.

- Vaksinimi mbron vetë personin dhe ndihmon në parandalimin e përhapjes së gripit.
- Efekti i vaksinës fillon 1 deri 2 javë pas marrjes dhe mbrojtja vazhdon rreth një vit pas vaksinimit.

## **VAKSINIMI**

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKSHPK në fillim të sezonës së gripit 2025/2026 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale) dhe me fillimin e sezonës ka filluar vaksinimi sipas rekomandimeve. Deri më 18 nëntor janë administruar gjithsej 50,042 doza të vaksinës kundër gripit sezonal. Prej tyre sipas grupeve të rrezikut: 34,000 janë administruar te grup-mosha mbi 65 vjeç, 14,489 me sëmundje kronike, 1,091 profesionistë shëndetësor, 6 gra shtatëzëna, 24 fëmijë (0-5 vjeç), 192 zyrtarë policorë dhe 25 mësimdhënës.

## **HOSPITALIZIMET**

Gjatë javës së fundit nga rastet e hospitalizuara në Klinikën Infektive, Klinikën e Pediatrisë dhe spitalet rajonale janë raportuar 67 raste me ARI, 13 raste me ILI, 6 raste me SARI dhe 1 rast me Influençë A.

**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE EVROPË****INFLUENCA SEZONALE JAVA 52/2025 NË EVROPË**

Gjatë javës 52, aktiviteti i infeksioneve respiratore në mbetet i rritur dhe mbi nivelet bazë për këtë sezonë, në shumicën e vendeve raportuese. Normat e sëmundjes së ngjashme me gripin dhe të infeksioneve akute respiratore janë mbi pragun bazë në pjesën më të madhe të vendeve, duke reflektuar intensifikim të qarkullimit viral në nivel rajonal. Të gjithë treguesit e aktivitetit të Influcës vijnë të rriten, me rritje të intensitetit, detektimeve laboratorike dhe pozitivitetit, ndërsa pozitiviteti më i lartë vërehet tek fëmijët e grupmoshës 5–14 vjeç. Paralelisht, hospitalizimet për Influcë janë në rritje, me barrën më të madhe tek personat mbi 65 vjeç. Influenca e tipit A(H3) mbetet virusi dominues në qarkullim, si në mbikëqyrjen sentinel të kujdesit parësor ashtu edhe në atë spitalore, duke konfirmuar një sezon të dominuar nga ky nën-tip, megjithëse qarkullojnë edhe viruse A(H1)pdm09 në përqindje më të ulët. Në të kundërt, treguesit rajonale të aktivitetit të SARS-CoV-2 vazhdojnë të bien dhe pozitiviteti mbetet i ulët krahasuar me Influcën, si në mbikëqyrjen sentinel ashtu edhe në rastet e infeksioneve respiratore akute të rënda. Qarkullimi i RSV-së po rritet gradualisht në nivel rajonal, kryesisht tek fëmijët nën moshën 5 vjeç, por aktualisht në nivele më të ulëta se ato të Influcës. Të dhënat nga mbikëqyrja e SARI tregojnë rritje të pozitivitetit për Influcën, ndërsa hospitalizimet dhe në kujdes intensiv janë raportuar në rritje vetëm në një numër të kufizuar vendesh. Vdekshmëria nga COVID-19 dhe vdekshmëria nga të gjitha shkaqet mbeten në nivele të pritshme për këtë periudhë, pa sinjale të tejkalimit të normave historike. Karakterizimi virologjik konfirmon dominimin e vazhdueshëm të Influcës A(H3), me disa klade në qarkullim, si dhe praninë më të kufizuar të viruseve A(H1)pdm09 dhe të Influcës B/Victoria. Për sezonin 2025/2026, rekomandimet e OBSH-së për përbërjen e vaksinës trivalente reflektojnë këtë situatë virologjike. Sa i përket SARS-CoV-2, varianti XFG mbetet linja mbizotëruese e raportuar në Evropë. Në tërësi, situata epidemiologjike në rajon karakterizohet nga një sezon i intensifikuar i Influcës, me ndikim më të theksuar tek fëmijët dhe të moshuarit, ndërkohë që aktiviteti i SARS-CoV-2 mbetet i ulët dhe nën kontroll, dhe RSV po rritet gradualisht pa arritur nivele alarmante.

Burimi: <https://erviss.org/>